

Edukimi i hershëm Psikopedagogjik/(i fëmijëve me nevoja të veçanta) u drejtohet familjeve të cilave u bie në sy mos zhvillim i duhur i fëmijëve të tyre, që nga lindja e deri në përfundimin e vitit të dytë të parashkollores

Kur është Edukimi i hershëm Psikopedagogjik i nevojshëm?

Atëherë kur fëmija tregon mos zhvillim të dukshëm, zhvillim të vonuar, ose tregon të meta në këto fusha:

- në lëvizje
- në gjuhë(të folurit)
- në perceptimin e sendeve
- në kontakt me të tjerë
- në lojë
- me emocionet(ndjenjat) apo përjetimet

Çfarë përfshin oferta jonë?

Këshillimi fillestar

Prindërit mund të drejtohen tek ne, nëse kanë ndonjë pyetje rreth zhvillimit të fëmijës. Gjatë konsullimit fillestar bisedohet me prindërit nëse është i nevojshëm vlersimi nga një profesionalist.

Diagnostifikimi

Në bisedë me prindërit dhe duke e vëzhguar fëmijën se si luan në loja të hapura dhe të strukturuar si dhe me anë të një testi të standartizuar, ne e shohim zhvillimin, personalitetin, pikat e forta dhe dobësitë e fëmijut dhe kështu mund të përcaktojmë nivelin e zhvillimit të tij.

Rezultatet e konsultimeve me prindërit dhe planifikojmë bashkërisht procedurën e mëturshme.

Nxitja/Përkrahja

Me anë të lojrave të përzgjedhura ne e inkurajojmë fëmijën që të fitojë aftësi të reja në lëvizje, në perceptim, në të folur dhe në sjelljen e tij në shoqëri. Ne e mbështesim fëmijën për të zbatuar aftësitë e tij në përballimin e përditshmërisë dhe e përforcojmë personalitetin e tij. Ne ofrojmë mbështetje individuale në shtëpi, apo në lokalet e Edukimit të hershëm Psikopedagogjik, gjithashtu i përkrahim edhe në grupe të vogla.

Që masat mbështetëse të mund të koordinohen dhe përshtaten me nevojat e fëmijës dhe prindërve, ne bashkëpunojmë edhe me specialistë të tjerë dhe departamente(qendra) tjera të specializuara.

Këshillimi

Me prindërit i bisedojmë problemet që vijnë si pasojë nga çrregullimi i zhvillimit apo sjellja e fëmijës, dhe sëbashku kërkojmë zgjidhje.

Ne gjithashtu udhëzojmë prindërit dhe personat tjerë përgjegjës, se si ata mund ta mbështesin fëmijën në mënyrë që ai aftësitë e fituara të mund të integroj dhe përdori në jetën e përditshme.

Bashkë me prindërit kërkohet mundësi për lehtësim dhe ju këshillojmë nëse keni pyetje rreth regjistrimit të fëmijut në kopshtin e lojrave, çerdhe apo në parashkollore.

Kush e merr pagesën përsipër?

Për prindërit me vendbanim në Kantonin e Cirikut, Edukimi i hershëm Psikopedagogjik, është falas.